



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Komuna e Vushtrrisë
Opstina / Municipality of Vushtri
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit



N J O F T I M

**THIRRJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË INTERESIT PËR NËN-PROJEKTIN:
RENOVIMI / RINDERTIMI I SHTËPIVE PRIVATE PËR FAMILJET E CENUESHME
NË KUADËR TË PROJEKTIT “BANIMI SOCIAL ADEKUAT”**

Komuna e Vushtrrisë njofton hapjen e Thirrjes Publike për Shprehje të Interesit për nën-projektin **“Renovimi/Rindërtimi i shtëpive private për familjet e cenueshme”** në kuadër të Projektit **“Banimi Social Adekuat”**. Nën-projekti synon të renovoje/ Rindertoj shtëpitë ekzistuese në pronësi të familjeve të cenueshme, të vjetra deri në atë mënyrë që të arrihen kushte më të përshtatshme jetese dhe më efikase në energji.

Projektet për Banimin Adekuat Social në Republikën e Kosovës do të funksionojnë nga Ligji Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjeve me Kredi në mes të Republikës së Kosovës, të paraqitura nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MPFT) dhe Zhvillimit të Bankës së Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin "Banimi Adekuat Social". Kredia nga BZHKE me vlerë totale prej 25 milionë eurosh, do t'i jepet si financim Komunave të Republikës së Kosovës, së bashku me kontributin nga MMPHI prej 12 milionë eurosh, për rritjen e numrit të njësive të banimit social dhe përmirësimin e kushteve të jetës për familjet me të ardhura të ulëta deri të mesme.

Ky Projekt ofron mundësinë për Komunat që të përfitojnë financim nga MMPHI për realizimin e projekteve për Banim Social Adekuat, përfshirja e projektit të rinovimit/rindërtimit të shtëpive private. Financimi i projektit në fjalë do të mbulojë kostot për rinovimin apo rindërtimin e shtëpive private duke u përmirësuar kështu kushtet e jetës për familjet e cenueshme që të përfitojnë me vështirësi ekonomike dhe që nuk mund të përfitojnë në bazë të banimit.

KUSH KA TË DREJTË TË APLIKOJË

Të drejtë të aplikimit mund të aplikojnë si familje apo individë që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten pa zgjedhur mundësinë e banimit si rezultat i një ose më shumë faktorëve, siç janë:

- Dëmtimit të shtëpisë private nuk i plotëson kushtet dhe është nën norma minimale të banimit për të qenë njësi banimi;
- Rrezikut të shkatrrimit për shkak të vjetërsisë së saj;
- Zhvendosje për shkak të investimeve publike apo për shkak të prishjes së shtëpisë private që nuk i plotëson kushtet për t'u legalizuar;
- Pamundësi së pagesës së qirasë me kushte të tregut;
- Familje apo individ pa përkujdesje;
- Fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu;
- Dëmtimin të shtëpisë private, njësisë së banimit gjatë luftës së vitit 1998/1999;
- Rrethanat e tjera të cilat Komunitat i konsiderojnë relevante në kontekstin lokal.

SI TË APLIKOHET

Njoftim për Thirrje Publike për Shprehje të interesit është i publikuar në faqet e internetit të Komunës dhe në platformat e tjera (rrjete sociale, TV lokale, radio, etj.), së bashku me të gjitha informacionet e nevojshme dhe të formuluarat për aplikime në këtë thirrje publike.

Shprehja e interesit bëhet duke tërhequr Formularin e Aplikimit pranë Komunës, apo duke shkarkuar atë nga Web faqja e Komunës. Formulari plotësohet dhe dorëzohet fizikisht pranë Komunës, duke bashkëngjitur edhe dokumentet e mëposhtme.

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN

1. Formularin e aplikimit të marrë në Komunë apo të shkarkuar në Web faqet e Komunës, të plotësuar me të gjithë të dhënat (e nënshkruar nga ana e aplikuesit);
2. Kopja e Letër-njoftimit të aplikusit;
3. Deklaratë për bashkësinë familjare;
4. Certifikatë apo dokument që dëshmojnë njëërën apo më shumë nga (16) kategoritë e listuara më poshtë;
5. Certifikatë pronësisë (fletë e poseduse të pronës jo më të vjetër se 6 muaj) ose dokument i noterizuar mbi disponueshmërinë e pronës;
6. Vendimi mbi posedimin e Lejes Ndërtimore të shtëpisë, legalizimit, apo dëshmisë se shtëpia është në proces të Legalizimit;
7. Fatura e tatimit në pronë për vitin 2025 e gjeneruar nga e-Kosova

PERIUDHA E APLIKIMIT

Thirrja për Shprehje të Interesit do të jetë e hapur nga data 26.08.2025 deri më 10.09.2025.

Formulari i plotësuar të shprehjes së interesit së bashku me të gjitha dokumentacionin e bashkangjitur, dërzohen në formë fizike në ndërtesën e Komunës, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 15:00.

Dorëzimi bëhet në zarf të mbyllur, në të cilin shkruhet:

- Emri i Aplikimit: **Rinovimi / Rindërtimi i shtëpive private për familjet e cënueshme**
- Emri dhe Mbiemri i Aplikuesit:
- Adresa e Aplikuesit:
- Të dhënat e aplikimit:

Gjithashtu informacione dhe sqarime shtesë mund të merren direkt nga zyra e Komunës - Njësi i Implementimit të Projekteve të Banimit Social.

Kontaktet e personave nga Komuna e Vushtrisë: Naim Ferizi, naim.ferizi@rks-gov.net, dhe Fatlum Hyseni fatlum.hyseni@rks-gov.net

